

**KONTRATE**  
**PER SHITJEN DHE TRANSFERIMIN E PJESEVE TE KAPITALIT**  
**TE SHOQERISE ALBANIA BEVERAGES GROUP SHPK**

Tirane, me 08.06.2022

**Z. Mirton Lika**, shtetas shqiptar, lindur me 20.09.1972, ne Kine dhe banues ne Tirane, mbajtes i Leter Njoftimit me numer 036076572, me numër personal H20920151B, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.

**Z. Maksim Haxhia**, shtetas shqiptar, lindur me 03.05.1958, ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, mbajtes i Leter Njoftimit me numer 034813075, me numër personal F80503035M, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.

**Z. Artan Hajdari**, shtetas shqiptar, lindur me 17.12.1968, ne Patos, banues ne Tirane, mbajtes i Leter Njoftimit me numer 035753503, me numër personal G81217022W, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar

**Z. Fidel Ylli**, shtetas shqiptar, lindur me 01.09.1962, ne Tirane, banues ne Tirane, mbajtes i Leter Njoftimit me numer 035584599, me numër personal G20901138Q, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar

**Zj. Vasilika Cakulli**, shtetase shqiptar, lindur me 01.01.1955, ne Gjirokaster, banuese ne Tirane, mbajtese e Leter Njoftimit me numër personal F55101363V, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar.

(ketu e me poshte quajtur "Shitesi/ja").

**Znj. Vilsa Lika**, shtetase shqiptare, lindur me 06.06.1972 ne Tirane, banues ne Tirane, mbajtese e Leter Njoftimit me numer 036076593, me numër personal H25606056M, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar

**Znj. Etleva Haxhia**, shtetase shqiptare, lindur me 24.12.1965, ne Vlore dhe banuese ne Tirane, mbajtes i pasaportes me numër personal G56224079R, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar

**Znj. Sonila Hajdari**, shtetase shqiptare, lindur me 24.05.1976, ne Vlore, banuese ne Tirane, mbajtese e Leter Njoftimit me numer 035770732, me numër personal H65524126T, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar

**Znj. Anita Ylli**, shtetase shqiptare, lindur me 17.09.1968, ne Elbasan, banuese ne Tirane, mbajtese e Leter Njoftimit me numer 038154348, me numër personal G85917032M, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar

**Z. Filip Cakulli**, shtetas shqiptar, lindur me 17.10.1955, ne Dermish, banues ne Tirane, mbajtes i Leter Njoftimit me numer 034768481, me numër personal F51017023U, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar



Dhe

(ketu e me poshte quajtur "Bashkeshorti/ja")

**Z.Artan Stroka** shtetas shqiptar, lindur me 22.07.1969, ne Tirane dhe banues ne Tirane, mbajtes i Leter Njoftimit me numer 037492615, me numër personal G90722158J;

(ketu e me poshte quajtur "Bleresi");

Palet e mesiperme, te kesaj Kontrate, do te referohen se bashku si "Palet".

**BAZA LIGJORE :** Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij; Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

**MEQENESE:**

- A. Albania Beverages Group shpk ("Shoqeria") eshte nje shoqeri e së drejtës shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregtar, ne Qendren Kombetare te Biznesit me numer unik NIPT K79818401U, date 12.12.2007, me seli ne adresen Berat Polican, perfaqesuar rregullisht nga Administratori Z. Besmir Doko;
- B. Shoqeria ka nje kapital te regjistruar prej 342.280.000 Leke, te ndare ne pronesi te ortakeve si me poshte:
- Ortaku Adriatik Zotkaj zotëron 1 kuote, qe perfaqeson 33% te kapitalit te regjistruar te saj ose 112.952.400 Leke
  - Ortaku Mirton Lika zotëron 1 kuote, qe perfaqeson 30% te kapitalit te regjistruar te saj ose 102.684.000 Leke
  - Ortaku Fidel Ylli zotëron 1 kuote, qe perfaqeson 9% te kapitalit te regjistruar te saj ose 30.805.200 Leke
  - Ortaku Maksim Haxhia zotëron 1 kuote, qe perfaqeson 9% te kapitalit te regjistruar te saj ose 30.805.200 Leke
  - Ortaku Artan Hajdari zotëron 1 kuote, qe perfaqeson 9% te kapitalit te regjistruar te saj ose 30.805.200 Leke
  - Ortaku Vasilika Cakulli zotëron 1 kuote, qe perfaqeson 5% te kapitalit te regjistruar te saj ose 17.114.000 Leke
  - Ortaku Platon Solis zotëron 1 kuote, qe perfaqeson 3% te kapitalit te regjistruar te saj ose 10.268.400 Leke
  - Ortaku Kudret Hoxha zotëron 1 kuote, qe perfaqeson 2% te kapitalit te regjistruar te saj ose 6.845.600 Leke.
- C. Shitesit së bashku deshirojnë te transferojne tek Bleresi pronesinë, permes shitjes se kuotave respektive, qe perfaqesojnë në total 62% te kapitalit themeltar te Shoqerise Albania Beverages Group shpk.

D. Njëkohësisht me transferimin e kuotave të Blerësi, palët kanë rënë dakort të ndryshojnë edhe mjetet e garantimit të shlyerjes së Kredisë kundrejt Bankës.

Sa me sipër, në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe neneve 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Palet bien dakort si me poshtë vijon:

### Neni 1

#### Objekti i Kontrates

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është transferimi i pronësive përmes shitjes së Kuotave që përfaqësojnë 62% të kapitalit të Shoqërisë, që Shitesit zotërojnë në Shoqëri, në favor të Blerësit.
- 1.2 Për sa me sipër, Shitesit shesin dhe transferojnë dhe Blerësi pranon pronësinë e Kuotave, sipas paragrafit 1.1. me sipër, përfshirë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pronësi si dhe detyrimet e tjera në lidhje me garantimin e Kredisë, sipas specifikimeve në këtë Kontratë.

### Neni 2

#### Cmimi i Shitjes, Pagesa dhe Garancite

- 2.1 **Cmimi i Shitjes:** Shitesit transferojnë dhe shesin Kuotat e tyre në favor të Blerësit, kundrejt cmimit prej 1.500.000 Euro (një milion e pesëqindmijë euro) ("Cmimi i Shitjes").
- 2.2 **Pagesa:** Cmimi i Shitjes do të paguhet nga Blerësi me keste sipas Planit të Shlyerjes me poshtë:
  - Kesti i Pare, në shumën 300.000 Euro, i pagueshem jo më vonë se 100 ditë pas vendosjes në punë të linjës së prodhimit/fabrikës, por në çdo rast jo më vonë se data 30.11.2022. Në momentin e vendosjes në punë të fabrikës, Blerësi ka detyrimin të njoftojë me shkrim Shitesit për këtë fakt.
  - Kesti i Dytë, në shumën 300.000 Euro, i pagueshem jo më vonë se data 30.11.2023;
  - Kesti i Tretë, në shumën 300.000 Euro, i pagueshem jo më vonë se data 30.11.2024;
  - Kesti i katërt, në shumën 300.000 Euro, i pagueshem jo më vonë se data 30.11.2025;
  - Kesti i pestë, në shumën 300.000 Euro, i pagueshem jo më vonë se data 30.11.2026;
- 2.3 **Garancia përmes Hipotekes:** Për të garantuar pagimin e plote të Cmimit të Shitjes, në përputhje me Planin e Shlyerjes, Blerësi do të ofrojë hipotekë të rradhës së parë mbi pasurinë e paluajtshme Nr.24/2, zona kadastrale 3666, me sipërfaqe totale 5000 m<sup>2</sup>, me Kod Unik 3666001221, për shumën e detyrimit të barabartë me e Cmimin e Shitjes. Për këtë qëllim, njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Palet do të angazhohen për të nënshkruar kontratën e hipotekës sipas këtij neni. Blerësi detyrohet të vendosë në dispozicion të Shitesit kartelen e pasurisë me regjistrimin perkates të hipotekës, për të vertetuar përmbushjen e këtij detyrimi kontraktor.
- 2.4 Në rast se Blerësi deshton të përmbushë këtë detyrim për nënshkrimin dhe regjistrimin e kontratës së hipotekës, Shitesit kanë të drejtë të përdorin këtë Kontratë dhe të regjistrojnë hipotekë mbi pasurinë e paluajtshme cituar më sipër. Për këtë qëllim kjo Kontratë dhe ky parashikim do të shërbejë si kontratë hipotekë në kuptim të neneve 560 e vijues të Kodit Civil.
- 2.5 **Garancia përmes barrës siguroese:** Për të garantuar pagimin e plote të Cmimit të Shitjes, në përputhje me Planin e Shlyerjes, Blerësi do të ofrojë barrë siguroese mbi linjën e prodhimit të përshkruar në mënyrë të detajuar në dokumentin bashkalidhur kësaj Kontrate, për shumën e detyrimit të barabartë me e Cmimin e Shitjes. Për këtë qëllim, njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Palet do të angazhohen për të nënshkruar kontratën e vendosjes së barrës siguroese sipas

ketij neni. Bleresi detyrohet te vendose ne dispozicion te Shitesit vërtetimin e regjistrimit të barrës siguroese, per te vertetuar permbushjen e ketij detyrimi kontraktor.

- 2.4 Ne rast se Bleresi deshton te permbushë kete detyrim per nenshkrimin dhe regjistrimin e kontrates se vendosjes së barrës siguroese, Shitesit ka te drejte te perdore kete Kontrate dhe te regjistrojë barrë siguroese mbi linjën e prodhimit cituar me siper. Në kuptim të këtij detyrimi dhe këtij parashikimi, kjo Kontratë përbën marrëveshje siguroese në kuptim të Ligjit nr. 8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguroese", i ndryshuar dhe Shitesit kanë të drejtë të regjistrojnë këtë Marrëveshje në Regjistrin e Barrëve Siguroese.

### Neni 3

#### Transferimi i Pronesise

- 3.1 Me nënshkrimin e kesa Kontrate, Bleresit i kalon menjehere titulli i pronesise mbi Kuotat e Shitesve, pavaresisht pageses se mevonshme te Cmimit te Shitjes, sipas Planit te Shlyerjes përcaktuar me siper.
- 3.2 Si rezultat i transferimit të pronësisë, Shitesit humbasin çdo te drejtë pronësie, te drejte mbi dividentin ose te drejta te tjera qe lindin nga titulli i pronesise mbi Kuotat dhe keto te drejta i kalojne Bleresit.
- 3.3 Palet bien dakord se mospagimi i plote apo i pjesshëm i Cmimit të Shitjes apo mosrespektimi i Planit te Shlyerjes përbën shkak që Shitesit të kërkojnë ligjërisht përmbushjen e këtij detyrimit, ekzekutimin e hipotekes dhe barrës siguroese.

### Neni 4

#### Detyrimet e Paleve

- 4.1 Palet pranojne te zbatojne dhe japin, me kerkese te pales tjeter dhe/ose Shoqerise, te gjithë dokumentacionin e duhur ne pergjithesi, per te finalizuar transferimin e Kuotes, objekt i kesaj Kontrate dhe per te regjistruar kete transferim ne Regjistrin Tregtar te Qendres Kombetare te Biznesit si dhe ne cdo organ tjeter shqiptar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 4.2 Per me tej, Palet pranojne te vendosin ne dispozicion te pales tjeter dhe/ose Shoqerise te gjithë dokumentacionin e duhur ne pergjithesi, per te ofruar garancite e nevojshme sipas kesaj Kontrate dhe regjistrimin e tyre ne regjistrat publike.
- 4.3 Ne rast se Bleresi deshton te permbushë kete detyrim per nenshkrimin dhe regjistrimin e kontrates se hipotekes dhe kontrates se vendosjes së barrës siguroese, Shitesit ka te drejte te perdore kete Kontrate dhe te regjistrojë hipoteke dhe barrë siguroese sipas percaktimeve ne kete nen. Në kuptim të këtij detyrimi dhe këtij parashikimi, ky nen i kesaj kontrate përbën njekohesisht kontrate hipoteke dhe marrëveshje siguroese dhe Shitesit kanë të drejtë të regjistrojnë këtë kontrate në regjistrat perkates publike.

### Neni 5

#### Dhenia e Pelqimit nga Bashkeshortja

- 5.1 Ne baze te parashikimeve te Ligjit Nr.9062, date 8.5.2003 "Kodi i Familjes" lidhur me regjimin e bashkesise ligjore, Bashkeshotet respektive të Shitesve, miratojnë permbajtjen e kësaj Kontrate lidhur me transferimin e pronesise se Kuotes nga Shitesi te Bleresi dhe per rrjedhoje deklarojnë se nuk kanë asnje pretendim, te tashem apo te ardhshem, ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate.

*[Handwritten signatures and initials in blue ink, including names like 'faul', 'Elliery', and others, scattered across the bottom of the page.]*

**Neni 6**

**Të ndryshme**

6.1 Palët garantojnë se ata kanë lexuar dhe kanë kuptuar Kontraten dhe nenet e saj.

6.2 Kjo kontrate është përgatitur në 3 (tre) kopje, në gjuhën Shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

**SHITËS:**

**Mirton Lika**

Mirton Lika

**Maksim Haxhia**

Maksim Haxhia

**Artan Hajdari**

Artan Hajdari

**Vasilika Cakulli**

Vasilika Cakulli

**DHËNËSE E PËLQIMIT**

**Bashkëshortji/ja i/e Shitësit/es**

**Vilsa Lika**

Vilsa Lika

**Etleva Haxhia**

Etleva Haxhia

**Anita Ylli**

Anita Ylli

**Sonila Hajdari**

Sonila Hajdari

**Filip Cakulli**

Filip Cakulli

**BLERËS**

**Artan Stroka**

Artan Stroka

Artan Stroka

Fidel Ylli